



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.Prot 2987

Kuçovë më 17/07/2026

NJOFTIM DHE RENDI I DITËS

Vendi :Salla e mbledhjeve, **Ditë:**e Merkure **Muaji:** Korrik **Viti:** 2026

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Kuçovë.

Drejtuar: Z/Znj _____

I nderuar këshilltar,

Ju njoftoj se ditën e Merkure date 22.07.2026, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Kuçovë zhvillohet mbledhja e radhës së Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari Këshillit në bazë të ligjit 139/2015 (neni 53, pika 4) me këtë rend dite:

RENDI I DITËS:

- ✓ Miratimi i proçesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak
- ✓ Miratimi i rendit të ditës së Mbledhjes.
- ✓ Paraqitja nga Këshilltarët e çështjeve dhe problematikave të komunitetit.
 1. **Projekt-vendim:**“Mbi ndryshimin e planit te buxhetit per blerje orendi zyre per shkollen “Aleksander Markacini”.”
 2. **Projekt-vendim**"Për bashkëfinancimin e shpenzimeve për organizimin e Festivalit Ndërkombëtar të filmit të pavarur KIFF.”
 3. **Projekt-Vendim:**”Për miratimin në parim të përfaqësimit të Bashkisë Kuçovë në strukturat e vendimarrjes së Grupit Vendor të Veprimit(GVV) ”Zëri i Beratit.”.
 4. **Projekt-vendim:**”Mbi konstatimin e pavleshmërisë absolute të kontratave për dhënien e objekteve/banesave me qera.”
 5. **Projekt-vendim:**”Për miratimin e projektit për ndërtimin e murit gabion për mbrojtjen lumore në Sinec si dhe ndërtimi i dy rampave mbi përroin në fshatrat Lumas dhe Luzaj,Njesia Administrative Lumas.”
 6. **Projekt-vendim:**”Për emërtimin e “Parkut të pishave”me emrin z.Sotir Rafaeli.”
 7. Informacion:Informacion për ujin e pijshëm në Bashkinë Kuçovë.
- ✓ Mbyllja e mbledhjes.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
ALEKSANDËR ZIU

Adresa: Lagjia nr.1, Blloku “T. Skendo”, Kuçovë
Email: bashkiakucove@yahoo.com

Telefon: +35531123306
Web: www.bashkiakucove.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Nr. Prot. 2923

Kuçovë, më 17/07/2026

PROJEKT - V E N D I M

Nr. 52, dt. 17.07.2026

Mbi ndryshimin e planit të buxhetit për blerje orendi zyre për shkollën “Aleksandër Markaçini”.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 23 dt. 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetë qeverisjes vendore”, Buxhetit të Bashkisë Kuçovë për vitin 2026 sipas V.K.B, nr. 60, dt. 12.12.2025, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresë nr. 965/2 dt. 24.12.2026.

KËRKOJMË:

Miratimin në ndryshimin e planit të buxhetit si vijon:

1. Pakësim i planit të buxhetit:

Institucioni	Gr-Prog.kap	Llog. ek	Kod projekti	Emërtimi	Shuma në lekë
124-2124009	00-09120-01	6090000	9999999	Fond rezervë	4,040,000

2. Shtesë plani në buxhet, për blerje orendi zyre për shkollën “Aleksandër Markaçini”.

Institucioni	Gr-Prog.kap	Llog. ek	Kod projekti	Emërtimi	Shuma në lekë
124-2124009	00-09120-01	2310000		Blerje orendi zyre	4,040,000

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Financës

Erjon Plaku

Heroina Shkempi

Drejtoria e Qendrës Ekonomike të Arsimit

Kozeta Mara

Sek/Këshillit Bashkiak

Alda Hodo

KRYETARI I BASHKISË

Kreshnik HAJDARI

2060
16.12.2026

Sekretare Këshillit
për zhvillim
Kesh



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KUÇOVË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT

Nr. Prot. 118

Kuçovë, më 16.01.2026

RELACION

LËNDA: Propozim mbi miratimin e fondit për projektin me objekt: "Blerje Pajisje Mobileri për Shkollat, për Shkollën e Mesme të Bashkuar "Aleksandër Markaçini", Havaleas, Kozare, Kuçovë.

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK KUÇOVË

Baza Ligjore:

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;

Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";

Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

Vendimi i Këshillit Bashkiak VKB Nr.60 Dt 12.12.2025 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Kuçovë për vitin 2026.

Bashkia Kuçovë, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të saj ligjore për sigurimin e kushteve optimale në institucionet e arsimit parauniversitar, ka si prioritet parësor modernizimin dhe pajisjen e shkollave me infrastrukturën e duhur mësimore.

Pas një verifikimi dhe inventarizimi fizik të kryer në terren nga specialistët e Qendrës Ekonomike të Arsimit pranë Bashkisë Kuçovë, është konstatuar se:

1. Amortizimi i lartë: Baza materiale ekzistuese (banka, karrige, tavolina mësuesish, dollapë klase) është e amortizuar plotësisht dhe daton prej shumë vitesh pa u rinovuar. Kjo gjendje nuk plotëson standardet e kërkuara të sigurisë dhe komoditetit për nxënësit dhe stafin mësimor.

2.Kushtet e vështira të mësimdhënies:Pamjaftueshmëria e dollapëve dhe pajisjeve laboratorike kufizon mundësinë e organizimit të bazës materiale të klasave dhe laboratorëve, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e procesit mësimor-edukativ.

Fondi i kërkuar prej 4,040,000 lekë (me TVSH) do të përdoret për blerjen dhe montimin e pajisjeve të reja të mobilerisë, të cilat përfshijnë specifikisht:

Banka mësimore dyshe dhe karrige për nxënësit (të përshtatshme për moshat e ndryshme arsimore);

Tavolina dhe karrige për mësuesit në çdo klasë;

Dollapë klase me dyer dhe rafte për ruajtjen e materialeve mësimore dhe portofolave të nxënësve;

Tabela mësimore dhe pajisje të tjera plotësuese për zyrat administrative të shkollës dhe dhomën e mësuesve.

Të gjitha pajisjet që do të blihen do të jenë të certifikuara sipas standardeve të cilësisë, rezistente ndaj përdorimit afatgjatë.

Burimi i Financimit:Ky investim propozohet të financohet nga të ardhurat e veta të Bashkisë Kuçovë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e vazhdueshëm në të mirë të komunitetit dhe arsimit në Bashkinë Kuçovë.

Drejtores e Q.E.A

Kozeta MARA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Nr. Prot 2982

Kuçovë, më 17 /07/ 2026

PROJEKT-V E N D I M

Nr. 53, dt. 17.07.2026
Për

Bashkëfinancimin e shpenzimeve për organizimin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Pavarur KIFF.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 ”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit standard për zbatimin e buxhetit nr.9, dt. 20.03.2018:

KËRKOJMË:

1. Miratimin e ndryshimit të planit në buxhet për bashkëfinancimin e shpenzimeve për organizimin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Pavarur KIFF. (Kuçova International Independent Film Festival), si më poshtë:

a. Pakësim plani për paga dhe sigurime shoqërore (për pozicionet e punës vakant):

Institucioni	Gr-Program-kap	Llog. ek	Kod projekti	Emërtimi	Në lekë
124-2124001	00-01110-05	6000000	9999999	Paga	1,169,000
124-2124001	00-01110-05	6010000	9999999	Sigurime shoqërore	191,000
124-2124001	00-06260-05	6000000	9999999	Paga	980,000
124-2124001	00-06260-05	6010000	9999999	Sigurime shoqërore	160,000
	Total				2,500,000

b. Shtesë plani për shpenzime operative:

Institucioni	Gr-Program-kap	Llog. ek	Kod projekti	Emërtimi	Në lekë
124-2124010	00-08220-05	6020000	9999999	Shpenzime operative	2,500,000
	Total				2,500,000

Drejtoria Juridike

Erjon Plaku

Drejtoria e Financës

Heroina Shkëmbi

Qendra Kulturore

Klodiana Misto

Sek/Këshillit Bashkiak

Alda Hodo

KRYETARI I BASHKISË

Kreshnik HAJDARI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
QENDRA KULTURORE KUÇOVË

Nr. Prot 2916

Kuçovë, më 14/07/ 2026

Lënda: Relacion për miratimin e shtesës së fondit në buxhetin vjetor të aktiviteteve për organizimin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Pavarur KIFF

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në kuadër të zbatimit të programit vjetor të aktiviteteve kulturore, ju paraqesim këtë kërkesë për miratimin e një shtese fondi në buxhetin e miratuar, me qëllim sigurimin e financimit të plotë për organizimin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Pavarur KIFF. “ Kuçova International Independent Film Festival”.

Bashkia Kuçovë në bashkëpunim me “Open Vision” SHPK kanë aplikuar me sukses në thirrjet kombëtare për financimin e projekteve kulturore dhe është shpallur fituese nga:

- Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, me një financim në vlerën 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë;
- Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), me një financim në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë.

Deri në këtë fazë, projekti ka siguruar financim publik në vlerën totale prej 4.300.000 lekësh, ndërsa pjesa tjetër e kostove do të mbulohet nga donatorë dhe partnerë mbështetës.

Vlera e përgjithshme e projektit është 11.825.000 (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e 25 mijë) lekë, ndërsa për realizimin e plotë të aktivitetit rezulton një nevojë shtesë financiare në masën 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, e cila kërkohet të akordohet përmes një shtese në buxhetin vjetor të aktiviteteve.

Ky financim është i domosdoshëm për përballimin e shpenzimeve operative dhe organizative të festivalit, duke përfshirë kostot e pritjes së të ftuarve, logjistikës, organizimit teknik, promovimit, jurisë ndërkombëtare dhe realizimit të programit artistik.

Interesi dhe rëndësia e këtij festivali janë evidentuar edhe nga pjesëmarrja e jashtëzakonshme ndërkombëtare, pasi deri më dt 08 korrik 2026 janë regjistruar 856 filma nga vende të ndryshme të botës për konkurrim, çka e pozicionon KIFF si një nga aktivitetet kulturore me impakt të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Drejtoria e Zhvillimit Rural

Nr. 2981/ Prot.

Kuçovë, më 17.07. 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 54. Datë 17 / 07 / 2026

"Për miratimin në parim të përfaqësimit të Bashkisë Kuçovë në strukturat e vendimmarrjes së Grupit Vendor të Veprimit (GVV) "Zëri i Beratit"

Këshilli Bashkiak Kuçovë, në mbështetje të nenit 8, nenit 54 dhe nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të Ligjit nr. Nr.9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", si dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë,

VENDOSI:

Neni 1

Miraton në parim përfaqësimin e Bashkisë Kuçovë në strukturat e vendimmarrjes së Grupit Vendor të Veprimit (GVV) "Zëri i Beratit", në përputhje me Statutin e shoqatës dhe metodologjinë LEADER.

Neni 2

Autorizohet Kryetari i Bashkisë Kuçovë për të ndërmarrë të gjitha veprimet administrative dhe ligjore që lidhen me zbatimin e këtij vendimi, përfshirë caktimin e përfaqësuesit të Bashkisë në organet drejtuese të GVV-së.

Neni 3

Ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Rural dhe strukturat përkatëse të Bashkisë Kuçovë për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Drejtör Juridik

Erion Plaku

Sek.Këshilli Bashkiak

Alda HODO



Drejtör i Zhvillimit Rural

Nazmi Suli

KRYETARI I BASHKISE
KRESHNIK HAJDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Drejtoria e Zhvillimit Rural

Nr. 2981 Prot.

Kuçovë, më 17.07 2026

RELACION

"Për miratimin në parim të përfaqësimit të Bashkisë Kuçovë në strukturat e vendimmarrjes së Grupit Vendor të Veprimit (GVV) "Zëri i Beratit""

I. Objekti

Ky relacion paraqitet për shqyrtimin dhe miratimin nga Këshilli Bashkiak Kuçovë të projektvendimit për miratimin në parim të përfaqësimit të Bashkisë Kuçovë në strukturat e vendimmarrjes së Grupit Vendor të Veprimit (GVV) "Zëri i Beratit", në përputhje me kuotat e përcaktuara nga metodologjia LEADER dhe programet e Bashkimit Evropian.

II. Baza ligjore

Projektvendimi mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligjin nr. Nr.9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural".
- Kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian për metodologjinë LEADER dhe Programin IPARD;

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur dhe të bazës ligjore në fuqi, vlerësohet se projektvendimi është në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, njeh të drejtën e bashkive për të bashkëpunuar me institucione publike, organizata jofitimprurëse dhe subjekte të tjera, me qëllim përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të tyre në interes të zhvillimit vendor. Po ashtu, ligji nr. Nr.9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", si dhe politikat kombëtare për zhvillimin rural, mbështesin krijimin e partneriteteve vendore sipas metodologjisë LEADER, si instrument për zhvillimin ekonomik, social dhe territorial.

Përfaqësimi i Bashkisë Kuçovë në strukturat drejtuese të GVV "Zëri i Beratit" nuk përbën transferim të funksioneve publike apo të pasurisë së bashkisë.

Nga analiza e dokumentacionit rezulton se miratimi i këtij projektvendimi nuk krijon detyrime financiare për buxhetin e Bashkisë, ndërsa krijon mundësi konkrete për përfitim të fondeve të Bashkimit Evropian dhe donatorëve të tjerë ndërkombëtarë.

Për sa më sipër, vlerësohet se projektvendimi është ligjor, i bazuar në kompetencat e Këshillit Bashkiak dhe rekomandohet miratimi i tij.

III. Arsyet e paraqitjes së projektvendimit

Grupi Vendor i Veprimit "Zëri i Beratit" është krijuar sipas metodologjisë LEADER, e cila përbën një nga instrumentet më të rëndësishme të Bashkimit Evropian për zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe nxitjen e partneritetit ndërmjet pushtetit vendor, sektorit privat dhe shoqërisë civile.

Qëllimi kryesor i këtij partneriteti është identifikimi i prioriteteve zhvillimore të territorit dhe krijimi i mundësive për përfitim të fondeve nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht nga Programi IPARD, fondet e Bashkimit Evropian dhe skemat e tjera të financimit për zhvillimin rural, bujqësinë, turizmin dhe ekonominë lokale.

Përfaqësimi i Bashkisë Kuçovë në strukturat vendimmarrëse të GVV "Zëri i Beratit" nuk përbën transferim kompetencash apo detyrimesh financiare për bashkinë, por krijon mundësinë që ajo të marrë pjesë aktive në procesin e planifikimit strategjik dhe koordinimit të projekteve zhvillimore në territor.

Në përputhje me standardet e metodologjisë LEADER, sektori publik ruan një rol të rëndësishëm në vendimmarrje, duke garantuar mbrojtjen e interesit publik, ndërkohë që vendimmarrja mbetet e balancuar me pjesëmarrjen e sektorit privat dhe shoqërisë civile.

IV. Impakti pozitiv

Miratimi i këtij projektvendimi pritet të sjellë një sërë përfitimesh për Bashkinë Kuçovë dhe komunitetin lokal, ndër të cilat:

- rritjen e mundësive për të përfituar financime nga programet e Bashkimit Evropian, Programi IPARD dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë;
- forcimin e partneritetit ndërmjet pushtetit vendor, fermerëve, sipërmarrjes dhe organizatave të shoqërisë civile;
- nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes së bujqësisë, agropërpunimit, turizmit rural dhe sipërmarrjeve vendase;
- krijimin e mundësive për investime të reja në infrastrukturën ekonomike dhe sociale të territorit;
- rritjen e kapaciteteve institucionale të Bashkisë në hartimin dhe zbatimin e projekteve me financim të jashtëm;
- përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional dhe të planifikimit të zhvillimit vendor;
- krijimin e kushteve për rritjen e punësimit, përmirësimin e të ardhurave të komunitetit rural dhe frenimin e emigrimit nga zonat rurale.

Pjesëmarrja e Bashkisë në këtë partneritet institucional përfaqëson një instrument të rëndësishëm për realizimin e objektivave të zhvillimit vendor dhe për përthithjen e burimeve financiare që nuk mund të sigurohen vetëm nga buxheti vendor.

V. Efektet financiare

Miratimi në parim i përfaqësimit të Bashkisë Kuçovë në strukturat e GVV "Zëri i Beratit" nuk sjell efekte të drejtpërdrejta financiare për buxhetin e Bashkisë.

Përkundrazi, pjesëmarrja në këtë strukturë krijon mundësi për sigurimin e financimeve të jashtme në funksion të realizimit të projekteve zhvillimore në territorin e Bashkisë Kuçovë.

VI. Përfundime

Duke qenë se përfaqësimi i Bashkisë Kuçovë në strukturat e GVV "Zëri i Beratit" është në përputhje me legjislacionin në fuqi, mbështet parimet e zhvillimit vendor, nxit bashkëpunimin publik-privat dhe krijon mundësi konkrete për përfitimin e fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare, propozohet që Këshilli Bashkiak Kuçovë të miratojë projektvendimin për përfaqësimin e Bashkisë në strukturat vendimmarrëse të Grupit Vendor të Veprimit "Zëri i Beratit", sipas kuotave të përcaktuara nga metodologjia LEADER.

Ky vendim pritet të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik, social dhe rural të territorit të Bashkisë Kuçovë, duke rritur mundësitë për investime, partneritete dhe zhvillim të qëndrueshëm në interes të komunitetit.

Kryetar i Bashkisë

Kreshnik HAJDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Nr. Prot. 2980/1

Kuçovë, më 17/07/2026

PROJEKT - V E N D I M

Nr. 55, dt. 17.07.2026

Shfuqizimin e kontratave për dhënien e objekteve/banesave me qera për vitet 2004-2015.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9632 datë 30.06.2006 "Për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar:

Kërkojmë:

1. Deklarimin të pavlefshëm të 78 kontratave për dhënie të objekteve/banesave me qera, pa i regjistruar më parë në ZRPP.
2. Pakësimin e debitorëve të lidhur me këto kontrata në shumën 8,921,960 lekë, sipas listës bashkëlidhur.

Drejtoria Juridike

Erion Plaku

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Heroina Shkambi

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit

Sokol Vasili

Sek/Këshillit Bashkiak

Alda Hodo

KRYETARI I BASHKISË

Kreshnik HAJDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Nr. Prot. 2980

Kuçovë, më 17/07/ 2026

Relacion

Mbi konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave për dhënien e objekteve/banesave me qera.

Projekt vendimi i paraqitur është në zbatim të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9632 datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar.

1. Në raportin përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit të ardhur me shkresë me nr. protokolli 32/6 dt. 30.04.2015, pika 7.1 rekomandon: “Bashkia Kuçovë të marrë masa dhe të kryejë procedurat administrative, bazuar në nenin 116, pika c të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Për kodin e Procedurës Administrative”, për deklarimin të pavlefshëm të 78 kontratave për dhënie të objekteve/banesave me qera, pa i regjistruar më parë në ZRPP, dhe në këto kushte nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore, pasi objekti i këtyre marrdhënieve kontraktuale nuk është në përputhje me nenin 678, të Kodit Civil, “Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet”, për shkak se prona, objekt i këtyre kontratave, përgjithësisht nuk është regjistruar në ZRPP, në pronësi të Bashkisë Kuçovë”.

Për të njëjtën çështje, në vendimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, të datës 24.11.2015, pika II, shprehimisht thuhet: kontratat e qerasë janë miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, dhe ndërpriten po me Vendim të Këshillit Bashkiak.

2. Detyrimi që lidhet me objektet të cilat rezultojnë të regjistruara në Z.V.R.P.P sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, familjet që banojnë në to, nuk janë strehuar si rezultat i zbatimit të një prej Programeve të Strehimit Social të parashikuara nga ligji Nr.9232, datë 13.05.2004 “Për Programet Sociale Të Strehimit” i ndryshuar, ligji i zbatueshëm në kohën të cilën janë lidhur këto kontrata (viti 2008).

Në këtë rast vetëm pas kalimit të afatit, sipas përcaktimeve në keto V.K.M mund të nisë zbatimin e skemës së qerasë, duke lidhur marrëdhënie kontraktore mbështetur në ligjin numër 48/2023

“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 22/2018 Për strehimin social”

Nisur këto argumenta dhe në rast kur Bashkia Kuçovë dispononte objekte me kontratë pronësie, përsëri kontratat kanë rezultuar të pavlefshme pasi edhe pse disponohej dokumenti i pronësisë, mënyra e kontraktimit të familjeve ishte e pabazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për Programet Sociale të Strehimit” i ndryshuar.

Drejtoria Juridike

Erion Plaku



Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Heroina Shkempi



Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit

Sokol Vasil

**KRYETARI I BASHKISË
Kreshnik HAJDARI**



Nr	Emer Mbiemer	Debia ne leke
1	Misir Mara	59,083
2	Shpetim Mara	164,941
3	Petrit Pire	84,693
4	Bilbil Zyka	369,000
5	Pushim Kanushi	332,100
6	Lulezim Dushku	287,820
7	Fatmir Shehu	254,241
8	Rrapi Xhafa	199,406
9	Afrim Xhafa	167,403
10	Bartolomeo Bullari	175,152
11	Hekuran Kila	84,132
12	Servet Shkempi	128,014
13	Mbarsie Kanani	53,427
14	Agron Daja	99,630
15	Kujtim Dushku	309,960
16	Haxhi Xhafa	113,295
17	Ramazan Mara	101,556
18	Irfan Dosti	144,000
19	Shpresa Dino	17,600
20	Saimir Senko	36,933
21	Floreta Barxhaj	42,630
22	Haxhi Lace	25,830
23	Qazim Sino	553,413
24	Klement Gorica	32,497
25	Simon Ndini	103,396
26	Andon Ahmetaj	88,560
27	Tofik Ahmetaj	118,080
28	Sadush Tafa	263,400
29	Resmije Dosti	20,664
30	Kostaq Ngjela	5,412
31	Stilian Thanasi	42,343
32	Luigj Gjoni	142,784
33	Daut Gega	199,137
34	Pandeli Dragoti	185,998
35	Kujtim Isollari	199,260
36	Morena Dardha	29,520
37	Ismail Doko	122,016
38	Qamil Mema	100,860
39	Kristaq Bixheku	74,988
40	Mynyre Olldash	51,734
41	Sherina Qevani	20,634
42	Toli Calamani	43,296
43	Orhan Seiti	20,900
44	Haki Zekthi	182,040
45	Banush Mehmeti	83,640

Nr	Emer Mbiemer	Debia ne leke
46	Fuat Toska	109,224
47	Agim Cacollari	37,420
48	Abduraman Alushi	110,781
49	Sokrat Xhemalaj	123,090
50	Vasil Fili	55,104
51	Elpiza Konomi	19,680
52	Daut Xhafa	118,166
53	Manol Manoli	174,788
54	Namik Zema	86,163
55	Sotirag Ndini	52,719
56	Sherif Zeqo	45,024
57	Dilaver Shabani	36,168
58	Hyqmet Cili	65,000
59	Sifi Shkempi	26,568
60	Ferdinand Hoxha	38,871
61	Petref Veizaj	39,852
62	Fiqiri Haxhallari	130,380
63	Shkelqim Hoxha	73,800
64	Vjollca Sherifi	64,846
65	Reshat Murati	238,128
66	Berti Hasko	162,360
67	Koli Dinaku	129,888
68	Gezim Kotruve	90,306
69	Krenar Kotruve	96,317
70	Artur Hamzaj	-
71	Gezim Salaj	47,253
72	(Jeol) Nuri Sala	39,360
73	Haki Sala	149,855
74	Gani Veisllari	78,228
75	Xhevdet Veisllari	196,800
76	Pellumb Rucaj	86,592
77	Mihal Luani	118,671
78	Halil Nazeraaj	145,140
	shuma	8,921,960

Nr	Emer Mbiemer	Debia ne leke
1	Misir Mara	59,083
2	Shpetim Mara	164,941
3	Petrit Pire	84,693
4	Bilbil Zyka	369,000
5	Pushim Kanushi	332,100
6	Lulezim Dushku	287,820
7	Fatmir Shehu	254,241
8	Rrapi Xhafa	199,406
9	Afrim Xhafa	167,403
10	Bartolomeo Bullari	175,152
11	Hekuran Kila	84,132
12	Servet Shkempi	128,014
13	Mbarsie Kanani	53,427
14	Agron Daja	99,630
15	Kujtim Dushku	309,960
16	Haxhi Xhafa	113,295
17	Ramazan Mara	101,556
18	Irfan Dosti	144,000
19	Shpresa Dino	17,600
20	Saimir Senko	36,933
21	Floreta Barxhaj	42,630
22	Haxhi Lace	25,830
23	Qazim Sino	553,413
24	Klement Gorica	32,497
25	Simon Ndini	103,396
26	Andon Ahmetaj	88,560
27	Tofik Ahmetaj	118,080
28	Sadush Tafa	263,400
29	Resmije Dosti	20,664
30	Kostaq Ngjela	5,412
31	Stilian Thanasi	42,343
32	Luigj Gjoni	142,784
33	Daut Gega	199,137
34	Pandeli Dragoti	185,998
35	Kujtim Isollari	199,260
36	Morena Dardha	29,520
37	Ismail Doko	122,016
38	Qamil Mema	100,860
39	Kristaq Bixheku	74,988
40	Mynyre Olldash	51,734
41	Sherina Qevani	20,634
42	Toli Calamani	43,296
43	Orhan Seiti	20,900
44	Haki Zekthi	182,040
45	Banush Mehmeti	83,640

Nr	Emer Mbiemer	Debia ne leke
46	Fuat Toska	109,224
47	Agim Cacollari	37,420
48	Abduraman Alushi	110,781
49	Sokrat Xhemalaj	123,090
50	Vasil Fili	55,104
51	Elpiza Konomi	19,680
52	Daut Xhafa	118,166
53	Manol Manoli	174,788
54	Namik Zema	86,163
55	Sotirag Ndini	52,719
56	Sherif Zeqo	45,024
57	Dilaver Shabani	36,168
58	Hyqmet Cili	65,000
59	Sifi Shkempi	26,568
60	Ferdinand Hoxha	38,871
61	Petref Veizaj	39,852
62	Fiqiri Haxhallari	130,380
63	Shkelqim Hoxha	73,800
64	Vjollca Sherifi	64,846
65	Reshat Murati	238,128
66	Berti Hasko	162,360
67	Koli Dinaku	129,888
68	Gezim Kotruve	90,306
69	Krenar Kotruve	96,317
70	Artur Hamzaj	-
71	Gezim Salaj	47,253
72	(Jeol) Nuri Sala	39,360
73	Haki Sala	149,855
74	Gani Veisllari	78,228
75	Xhevdet Veisllari	196,800
76	Pellumb Rucaj	86,592
77	Mihal Luani	118,671
78	Halil Nazeraj	145,140
	shuma	8,921,960

Nr	Emer Mbiemer	Debia ne leke
1	Misir Mara	59,083
2	Shpetim Mara	164,941
3	Petrit Pire	84,693
4	Bilbil Zyka	369,000
5	Pushim Kanushi	332,100
6	Lulezim Dushku	287,820
7	Fatmir Shehu	254,241
8	Rrapi Xhafa	199,406
9	Afrim Xhafa	167,403
10	Bartolomeo Bullari	175,152
11	Hekuran Kila	84,132
12	Servet Shkempi	128,014
13	Mbarsie Kanani	53,427
14	Agron Daja	99,630
15	Kujtim Dushku	309,960
16	Haxhi Xhafa	113,295
17	Ramazan Mara	101,556
18	Irfan Dosti	144,000
19	Shpresa Dino	17,600
20	Saimir Senko	36,933
21	Floreta Barxhaj	42,630
22	Haxhi Lace	25,830
23	Qazim Sino	553,413
24	Klement Gorica	32,497
25	Simon Ndini	103,396
26	Andon Ahmetaj	88,560
27	Tofik Ahmetaj	118,080
28	Sadush Tafa	263,400
29	Resmije Dosti	20,664
30	Kostaq Ngjela	5,412
31	Stilian Thanasi	42,343
32	Luigj Gjoni	142,784
33	Daut Gega	199,137
34	Pandeli Dragoti	185,998
35	Kujtim Isollari	199,260
36	Morena Dardha	29,520
37	Ismail Doko	122,016
38	Qamil Mema	100,860
39	Kristaq Bixheku	74,988
40	Mynyre Olldash	51,734
41	Sherina Qevani	20,634
42	Toli Calamani	43,296
43	Orhan Seiti	20,900
44	Haki Zekthi	182,040
45	Banush Mehmeti	83,640

Nr	Emer Mbiemer	Debia ne leke
46	Fuat Toska	109,224
47	Agim Cacollari	37,420
48	Abduraman Alushi	110,781
49	Sokrat Xhemalaj	123,090
50	Vasil Fili	55,104
51	Elpiza Konomi	19,680
52	Daut Xhafa	118,166
53	Manol Manoli	174,788
54	Namik Zema	86,163
55	Sotirag Ndini	52,719
56	Sherif Zeqo	45,024
57	Dilaver Shabani	36,168
58	Hyqmet Cili	65,000
59	Sifi Shkempi	26,568
60	Ferdinand Hoxha	38,871
61	Petref Veizaj	39,852
62	Fiqiri Haxhallari	130,380
63	Shkelqim Hoxha	73,800
64	Vjollca Sherifi	64,846
65	Reshat Murati	238,128
66	Berti Hasko	162,360
67	Koli Dinaku	129,888
68	Gezim Kotruve	90,306
69	Krenar Kotruve	96,317
70	Artur Hamzaj	-
71	Gezim Salaj	47,253
72	(Jeol) Nuri Sala	39,360
73	Haki Sala	149,855
74	Gani Veisllari	78,228
75	Xhevdet Veisllari	196,800
76	Pellumb Rucaj	86,592
77	Mihal Luani	118,671
78	Halil Nazeraaj	145,140
	shuma	8,921,960



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Nr. Prot. 2985

Kuçovë, më 17/07/2026

PROJEKT-V E N D I M

Nr. 56, dt. 17.07.2026

Për miratimin e projektit për ndërtimin e murit gabion për mbrojtjen lumore në Sinec si dhe ndërtimi i dy rampave mbi përroin në fshatrat Lumas dhe Luzaj, Njësia Administrative Lumas.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23 dt. 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetë qeverisjes vendore”, Udhëzimit standard për zbatimin e buxhetit nr.9, dt. 20.03.2018, shkresave të AKMC nr.429/6 prot., dt. 15.04.2026 dhe nr.1333/3 prot., dt. 02.06.2026:

KËRKOJMË:

1. Miratimin e projektit për ndërtimin e murit gabion për mbrojtjen lumore në Sinec si dhe ndërtimi i dy rampave mbi përroin në fshatrat Lumas dhe Luzaj, si vijon:

Institucioni	Gr- Prog.kap	Llog. ek	Kod projekti	Emërtimi	Shuma në lekë
124-2124001	17-10910-01	2310000		Ndërtim muri gabion për mbrojtje lumore në Lumas, ndërtim i dy rampave në Luzaj dhe Lumas.	2,456,159
124-2124001	17-10910-01	2310000		Ndërtim muri gabion për mbrojtje lumore në Lumas, ndërtim i dy rampave në Luzaj dhe Lumas, supervizim.	63,228
124-2124001	17-10910-01	2310000		Ndërtim muri gabion për mbrojtje lumore në Lumas, ndërtim i dy rampave në Luzaj dhe Lumas, kolaudim.	9,484
Total					2,528,871

2. Financimi i projektit do të kryhet me fondet e akorduara nga Ministria e Mbrojtjes për mbrojtjen civile.

Drejtoria Juridike

Erjon Plaku

Drejtoria e Financës

Heroina Shkambi

Drejtoria e Planifikimit të Territorit

Sokol Vasili

Sek/Këshillit Bashkiak

Alda Hodo

KRYETARI I BASHKISË
Kreshnik HAJDARI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË FIGURAVE**

Nr. 2984/11 Prot.

Kuçovë, më 17.07. 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 57, datë 17.07 2026

“PËR EMËRTIMIN E “PARKUT TË PISHAVE” ME EMRIN Z.SOTIR RAFAELI”.

Në mbështetje nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, pika1, nenpika 1.1, shkronja b, nenpika 1.7, shkronja b, nenit 54, shkronja ll, nenit 54 pika 2 dhe pika 6, të ligjit nr. 139 /2015 “ Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 3 të ligjit 9270 datë 29.07.2004 “ Për sistemin e adresave të ndryshuar, si dhe ligjit 107/2014 “ Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar:

VENDOSI:

Të emërtojë Parkun e Pishave me emrin Z.Sotir Rafaeli,

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari i Komisionit të Vleresimit të Figurave

Sybi Shehu

Drejtori i Drejtorisë Juridike
Erion Plaku

Sek. i Këshillit Bashkiak

Alda Hodo

**KRYETARI I BASHKISË
KRESHNIK HAJDARI**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË FIGURAVE**

Nr. 2984 Prot.

Kuçovë, më 17.07. 2026

Lënda: Relacion “Për emertimin e parkut të pishave me emrin z.Sotir Rafaeli”.

KËSHILLIT BASHKIAK KUÇOVË

Pranë Bashkisë Kuçovë është paraqitur kërkesa e shoqatës kulturore “Kuçova”, për vlerësimin e figurës së z.Sotir Rafaeli, si person me një kontribut të madh në fushën urbane të qytetit të Kuçovës.

Bashkia Kuçovë ka si prioritet lehtësimin e sistemit të adresave për qytetarët si dhe për të vlerësuar figurat që kanë dhënë kontribut për qytetin tonë,

Më poshtë po ju përshkruajmë historikun e z.Sotir Rafaelit,:

Kontributi i Z. Sotir Rafaelit në Kuçovë

Sotir Rafaeli lindi në 5 gusht 1920 në Gostivisht të Ersekës, në një familje me tradita patriotike dhe intelektuale të njohura në krahinë. Arsimin fillor e kreu në vendlindje dhe më pas shkollën qytetësë në Erseke, më pas si nxënës i shkëlqyer u dërgua në Stamboll me studime të mesme, në degën Ekonomi. Në vitin 1942 filloi punë në Ministrinë e Punëve Botore, pas çlirimit të vendit në vitin 1944, u caktua specialist ekonomist pranë Komisiariatit të Naftës, në vitin 1946 u emërua Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Rajonit të Naftës në Kuçovë, punë që e ushtroi deri në vitin 1960. Gjatë kësaj kohe, falë aftësisë së tij drejtuese dhe vizionit për zhvillimin urban i dha një fytyrë të re qytetit të Kuçovës. Një nga kontributet e tij më të mëdha është krijimi i Parkut të Pishave, rreth vitit 1950 kjo zonë rreth 3 hektarë, ishte një territor i mbulluar me ferra dhe shkurre. Falë vizionit të z.Sotir Rafaelit kjo hapësirë u shëndërrua në një zonë të gjelbër dhe rekreative për qytetin, i njohur si Parku i Pishave.

Nga sa më sipër, është në vlerësimin tuaj të miratoni ndryshimet e emërtimit të parkut, me emrin Sotir Rafaeli .

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj!

Konceptoi: Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Figurave
Z. Sybi Shehu



Nikryetar S. Shehu
Komiteti Ekzekutiv i Rajonit të Naftës
për Kujtimin

Kuqovë më 12.03.2026

Lënda: Propozim për emërtimin e "Parkut të Pishave" me emrin e z. Sotir Rafaeli

I nderuar z. Kryetar,

Shoqata Kulturore "**Kuçova**", e themeluar në prill të vitit 2004 dhe e miratuar nga Gjykata e Tiranës, vijon aktivitetin e saj në përputhje me programin dhe statutin e saj, me synim evidentimin dhe promovimin e vlerave historike, kulturore dhe qytetare të trevës së Kuçovës.

Në kuadër të vlerësimit të personaliteteve që kanë dhënë kontribute të rëndësishme për zhvillimin e qytetit dhe komunitetit, Shoqata Kulturore "**Kuçova**" paraqet këtë **propozim** për emërtimin e **Parkut të Pishave**, i cili ndodhet në zemër të qytetit të Kuçovës, me emrin e z. **Sotir Rafaeli**.

Z. Sotir Rafaeli, banor i Kuçovës që prej vitit 1945 dhe i shpallur "**Qytetar Nderi**" i Kuçovës në vitin 2010, është një nga figurat që ka dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe organizimin e jetës urbane të qytetit.

Ai lindi më **5 gusht 1920** në **Gostivisht të Ersekës**, në një familje me tradita patriotike dhe intelektuale të njohura në krahinë. Arsimin fillor e kreu në vendlindje dhe më pas shkollën qytetase në Ersekë. Si nxënës i shkëlqyer u dërgua për të vazhduar studimet e mesme në **Stamboll**, në degën ekonomike.

Pas një eksperience të shkurtër pune në Stamboll, ai u kthye në Shqipëri. Në vitin **1942** filloi punë në **Ministrinë e Punëve Botore**. Pas çlirimit të vendit në vitin **1944**, u caktua specialist ekonomist pranë **Komisariatit të Naftës**, institucion i sapokrijuar për zhvillimin e sektorit të naftës.

Në vitin **1946** u emërua **Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Rajonit të Naftës në Kuçovë**, detyrë që e ushtroi deri në vitin **1960**. Gjatë kësaj periudhe rreth 15-vjeçare, falë aftësive të tij drejtuese dhe vizionit për zhvillimin urban, Kuçova u transformua nga një vendbanim me tipare fshatare në një qytet të zhvilluar, me përmirësime të ndjeshme në infrastrukturë, shërbime publike, kulturë, art dhe sport.

Një nga kontributet më të rëndësishme dhe më të qëndrueshme për komunitetin mbetet krijimi i **Parkut të Pishave**. Sipas dëshmive të banorëve të vjetër të qytetit, rreth vitit **1950** kjo zonë, me një sipërfaqe rreth **3 hektarë**, ishte një territor i mbuluar me shkurre dhe ferrishte.

Falë vizionit, këmbënguljes dhe nismës së z. **Sotir Rafaeli**, kjo hapësirë u shndërrua në një zonë të gjelbër dhe rekreative për qytetin, e njohur sot si **Parku i Pishave**, një nga hapësirat më të dashura për banorët e Kuçovës. Sipas kujtimeve të paraardhësve tanë, ky park u krijua kryesisht përmes **punës vullnetare të qytetarëve kuçovarë**.

Pas vitit 1960, z. Sotir Rafaeli ka mbajtur edhe detyra të tjera të rëndësishme drejtuese në institucione të qytetit deri në daljen e tij në pension.

Një fakt simbolik dhe domethënës është se, në fillim të detyrës së tij si Kryetar i Komitetit Ekzekutiv, gjatë procesit të regjistrimit të popullsisë së qytetit, qytetari i parë i regjistruar në librin e popullatës, me numrin 1, ishte vetë z. Sotir Rafaeli.

Për kontributin e tij të çmuar në zhvillimin urban dhe jetën komunitare të Kuçovës, si dhe për rolin e tij në krijimin e një prej hapësirave më të rëndësishme publike të qytetit, Shoqata Kulturore “Kuçova” propozon që Parku i Pishave të emërtohet “Parku Sotir Rafaeli”, si një vlerësim i merituar për figurën dhe veprën e tij.

Me respekt,

Kryetari

z. Shkelqim Agaj

Shoqatës

Kulturore

SHOQATA
KULTURORE
“KUÇOVA”

Sekretari

z. Ilirjan Koxhaj

SHOQATA
KULTURORE
“KUÇOVA”